





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RTK 1
Lorik Arifaj
Drejtore
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2020/55 - Devolli Group (Palë ankuese) kundër
RTK 1 (Palë përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 11 maj 2020 ka pranuar një Ankesë nga Pala ankuese ndaj emisionit “Jeta në Kosovë” me titull “*Monopoli me dritë të diellit ZRRE dhe Devolli Group*” të transmetuar në RTK 1 me datën 30 prill 2020. Përmes ankesës Pala ankuese pretendon se: “*Gjatë gjithë transmetimit të këtij emisioni përdoret një gjuhë denigruese me qëllim të dëmtimit të imazhit të kompanisë dhe emrit tim duke përdorur fraza si “Baba Blerim Devolli”, “Nanë Blerim Devolli”, “tu i qeru si kepen e gjen qe e kanë nanë Blerim Devollin”, “Devollëve t’shkretë”, “Qe çka bon shteti i fortë për Devollët e shkretë” dhe në disa raste përmendet “skema e fshehjes së pronarëve të vërtetë”, e cila është e pavërtetë dhe tendencë për të paraqitur emrin tim si të inkriminuar në punë të jashtëligjshme si përfitues nga “xhepi i konsumatorit”, duke përdorur fraza me të cilat mundohet të bindë shikuesin për diçka që nuk qëndron.”*
3. KPM me datën 14 maj 2020, me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese, ka kërkuar nga RTK 1 që brenda tre (3) ditësh të sjellë sqarim lidhur me Ankesën në fjalë.
4. KPM me datën 26 maj 2020 ka pranuar Përgjigje nga RTK 1, përmes së cilës pretendon se: “*thelbi i emisionit ka të bëjë me faktin ses 6 kompani në pronësi të z. Blerim Devolli kanë përfituar tarifa nxitëse për prodhim të energjisë së ripërtrishme në total prej 16.7 megavat, ndërsa sipas vendimit të ZRRE-së përcaktohet se maksimumi për një aplikues duhet të jetë deri në 3 megavat dhe është ngritur shqetësimi se zhvillimi i këtyre*

procedurave krijon mundësi për krijim të monopolit për kompani të caktuara dhe se e gjithë përmbajtja dhe narracioni i emisionit në asnjë moment dhe asnjë mënyrë nuk ka konotacion ofendues ndaj Palës ankuese, por synon të shpalosë, thjeshtësojë dhe ilustrojë kompleksitetin e skemës së fshehjes së bizneseve me qëllim të përfitimit.” Në përgjigjen e RTK 1 janë bashkangjitur dy dëshmi nga ARBK se biznesi “Devolli Group Shpk” ndërron emërtimin në “Abrazen L.L.C” dhe një foto e marrë nga ueb faqja e Comodita Home. Ndërsa, dëshmitë e tjera të përmendura në sqarim vetëm janë përshkruar.

5. KPM ka analizuar ankesën e Palës ankuese, si dhe ka monitoruar emisionin e lartpërmendur dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 9 qershor 2020, ka gjetur se RTK 1 ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 10 qershor 2020, i ka dërguar RTK 1 Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e ka udhëzuar që në afat prej tre (3) ditësh, duke u bazuar në nenin 29, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së, të paraqesin fakte ose dëshmi shtesë në lidhje me shkeljet e pretenduara.
7. KPM me datën 12 qershor 2020 ka pranuar përgjigje nga RTK 1, mirëpo në të nuk ka pasur të bashkangjitura fakte ose dëshmi shtesë në lidhje me shkeljet e pretenduara, por vetëm janë përshkruar me fjalë.
8. KPM me datën 30 tetor 2020 mori Vendim që RTK 1 ta dënojë me Vërejtje për shkelje të nenit 5, paragrafi 2 dhe 5, nenit 6, paragrafi 1, si dhe nenit 7, paragrafi 6 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë.
9. RTK 1 me datën 7 dhjetor 2020 ka parashtruar Ankesë kundër Vendimit të Komisionit në Bordin për Ankesa.
10. Bordi për Ankesa e ka shqyrtuar Ankesën e RTK 1 dhe me Vendimin e datës 13 janar 2021 e aprovoi si të bazuar Ankesën e RTK 1 dhe anuloi Vendimin e Komisionit të Pavarur të Mediave, duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje, me arsyetimin se në Vendimin e KPM-së nuk janë analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat siç parashihet me nenet 86, 88 dhe 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Analiza ligjore

11. Komisioni i KPM-së, pas analizimit të provave të bashkangjitura me Ankesën e drejtuar në Bordin për Ankesa, sqarimeve të ofruara nga RTK 1 dhe Raportit të monitorimit, gjen se RTK 1 ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, respektivisht me nenin 5, paragrafi 2 dhe 5, nenin 6, paragrafi 1, si dhe nenin 7, paragrafi 6.
12. KPM pas Vendimit të Bordit për Ankesa, me të cilin e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje, ka analizuar edhe një herë të gjithë rastin dhe provat e bashkangjitura të RTK 1 në Ankesën drejtuar Bordit për Ankesa. Provat e reja i ka trajtuar dhe analizuar në raport me shkeljet e konstatuara me Vendimin e Komisionit të datës 30 tetor 2020.

13. KPM në Vendimin Ref:2011/836/KPM/xhl ka gjetur se RTK1 me transmetimin e emisionin “Jeta në Kosovë” ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2 dhe 5, dhe nenit 7 paragrafi 6, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, të cilët përcaktojnë se:

“Raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose tjetër; prejardhja kombëtare a shoqërore; lidhja me ndonjë komunitet; prona; orientimi seksual, ekonomik dhe shoqëror; lindja, aftësia e kufizuar apo çfarëdo statusi tjetër personal nuk duhet të përdoret në atë mënyrë që individët të vihen në pozitë denigruese, të pafavorshme, të përqeshen apo tallen.”

“OSHM-të nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtjen dhe pabarazinë dhe që mund të rezultojnë me veprime kriminale ose të dhunshme kundër një individi apo grupi.”

“Programet që kanë qëllim të keq, përmbajnë kritikizëm të padrejtë apo sulm në një person fizik apo juridik, janë të ndaluara.”

14. KPM, bazuar në Raportin e monitorimi të datës 9 qershor 2020, ka gjetur se gjatë transmetimit të emisionit “Jeta në Kosovë” është përdorur gjuhë që ka qenë në kundërshtim me nenet e lartpërmendura. Me përdorimin e shprehjeve “Devollët e shkretë”, “Baba Blerim Devolli”, “Nona Blerim Devolli” dhe “Qe çka bon shteti i fortë për Devollët e shkretë”, Pala ankuese është vënë në pozitë denigruese, të pafavorshme dhe tallëse, duke vepruar në shkelje të nenit 5 paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

15. Ndërsa, duke deklaruar se konsumatorët do të paguajnë më shtrenjtë në mënyrë që të përkrahen 6 bizneset e Devolli Group (Palës ankuese) dhe se nga xhepi i konsumatorëve në llogari të kompanive të Devollit do të derdhen 14.4 milion euro, RTK 1 ka bërë trajtim tendencioz dhe kritikizëm të padrejtë në raport me Palën ankuese. Përdorimi shprehjeve të tilla ka mundur të nxisë urrejtje nga ana e publikut ndaj Palës ankuese dhe ka mundur të rezultojë në veprime të dhunshme ndaj Palës ankuese, veprim ky i cili është në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 5 dhe nenin 7, paragrafi 6, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

16. Me këto deklarata është krijuar përshtypja se shkaktari për përcaktimin e këtyre tarifave është Pala ankuese e jo ZRRE, derisa tarifat i ka përcaktuar Vendimi i ZRRE-së si organ i pavarur, e jo Pala ankuese, siç pretendohet nga RTK 1. Kjo vërtetohet edhe në vetë Ankesën e RTK 1 të drejtuar Bordit për Ankesa, të datës 7 dhjetor 2020 ku theksohet se: *“interesat e qytetarëve janë dëmtuar drejtpërsëdrejti nga Vendimi i ZRRE-së...”,* që argumenton gjetjen e shkeljes në Vendimin e KPM-së se: *“gjuha e përdorur në emisionin “Jeta në Kosovës” i transmetuar në RTK1, paraqet trajtim tendencioz në raport me Palën Ankuese, duke përmendur edhe se si konsumatorët do të paguajnë më shtrenjtë në mënyrë që të përkrahen 6 bizneset e Palës Ankuese dhe se nga xhepi i konsumatorëve në llogari të kompanive të Palës Ankuese do të derdhen 14.4 milion euro, duke krijuar kështu përshtypjen se shkaktari për përcaktimin e këtyre tarifave është Pala Ankuese e jo ZRRE.”*

17. Provat e bashkangjitura nga RTK 1 lidhur me shkeljet e nenit 5, paragrafi 2 dhe 5, dhe nenit 7, paragrafi 6, të cilat kanë të bëjnë me Vendimet e ZRRE (Prova 5, 9 dhe 10) dhe dëshmitë nga institucionet e ndryshme (Prova 33, Prova 34), argumentojnë konstatimin e

KPM-së se Pala ankuese nuk është përgjegjëse për procedurat e zhvilluara dhe tarifrat e përcaktuara. Prandaj, këto prova nuk janë relevante lidhur me shkeljet e lartpërmendura.

18. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit, gjithashtu ka gjetur se RTK 1 duke e transmetuar emisionin “Jeta në Kosovë” ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t’i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues.”

19. KPM, sa i përket shkeljes së këtij neni, ka gjetur se në emisionin “Jeta në Kosovë” Pala ankuese ndërlihet me aktivitete biznesore në prodhimin e produkteve si jastëk, dyshekë, kafe, biznese këto të cilat nuk janë në pronësi të Palës ankuese. Po ashtu, sa i përket ndërlihdjes me çështjen e Telekomit dhe Zmobile, sipas emisionit thuhet se: *“qeky asht Blerim Devolli që o thirr prej parlamentit të kalum me dëshmu në komisionin hetimor, si pronar i Zmobile, se qysh e ka dëmtu Valën e Kosovës”*, duke konstatuar se Pala ankuese e ka dëmtuar Valën e Kosovës. Faktet e ofruara nga RTK 1, përkatësisht Prova 28, tregojnë se Kuvendi ka kërkuar hetim lidhur me rastin nga Prokuroria e Shtetit, dhe përderisa nuk ka vendim final pas këtij procesi nga organet kompetente nuk mund të konsiderohet se Pala ankuese ka dëmtuar Valën e Kosovës, por Pala ankuese mund të jetë palë “e dyshuar” për pretendim të tillë. Edhe kjo provë ka rezultuar si jorelevante me rastin në fjalë.
20. Sa i përket pretendimit të RTK 1 se emisioni *“Monopoli me dritë të diellit – ZRRE dhe Devolli”* është shpërblyer si emisioni më i mirë për ekonomi *“Ibrahim Rexhepi”* për vitin 2020 nga OSBE dhe AGK dhe ka rezultuar me impakte të drejtpërdrejta duke shkaktuar reagimin e institucioneve më të larta të vendit për adresimin e gjetjeve të emisionit” (Prova 32), KPM vlerëson se nuk merret me vlerësimin e emisioneve sa i përket impakteve që mund të rezultojnë nga emisione të caktuara. KPM merret vetëm me vlerësimin e përmbajtjeve programore për të cilat parashtrihen ankesa dhe konstatimet për shkelje të paraqitura në Vendim janë vetëm për pjesët për të cilat është konstatuar se janë bërë shkelje. Në Vendim janë paraqitur vetëm shkeljet që janë konstatuar në bazë të të gjeturave nga vlerësimi i Ankesës.
21. Lidhur me pretendimin e Palës Ankuese se *“në disa raste përmendet skema e fshehjes së pronarëve të vërtetë e cila nuk është asgjë përveç një e pavërtetë e pafaktuar dhe tendencë për të paraqitur Blerim Devollin si të inkrimnuar në punë të jashtëligjshme”*, KPM ka vlerësuar se ky pretendim i Palës ankuese nuk qëndron për faktin se në emision janë transmetuar dëshmi që ndërlihen me këtë çështje si dhe është theksuar se Palës ankuese i është dhënë e drejta për përgjigje ndaj këtij pretendimi, por nuk e ka shfrytëzuar. Përderisa nuk janë paraqitur dëshmi nga Pala ankuese se konstatimet e RTK 1 për fshehje të kompanisë nuk qëndrojnë, pretendimi i Palës ankuese ndaj konstatimeve të RTK 1 për fshehje të pronësisë nuk është marrë parasysh nga KPM. KPM ka analizuar provat që ndërlihen me rastin në fjalë (Provat: 4, 6, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 33, 34 dhe 35), dhe ka vlerësuar se janë jo relevante, sepse RTK 1 nuk është gjetur në shkelje lidhur me pretendimin për fshehje të bizneseve, për faktin se RTK 1 ka ofruar dëshmi dhe rrjedhimisht ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

22. KPM nga analizimi i provave vlerëson se nuk i ka kontestuar të gjeturat në RTK 1 sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me parregullsitë e mundshme gjatë këtij procesi, konfliktit të mundshëm të interesit, konkurrencës etj. (Provat: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24.)
23. Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura dhe në analizimin e provave të RTK 1 të bashkangjitura në Ankesën drejtuar Bordit për Ankesa ka gjetur se RTK 1 ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2 dhe 5, nenin 6, paragrafi 1, dhe nenin 7 paragrafi 6, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

24. Pala Përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 5, paragrafi 2 dhe 5, nenit 6 paragrafi 1, dhe nenit 7 paragrafi 6, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për ankesë

25. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
26. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



28.01.2021
Datë